

INSTITUTI I KURRIKULËS DHE I TRAJNIMIT

**PROGRAMI ORIENTUES PËR PROVIMIN E LIRIMIT NË
LËNDËN E GJUHËS SHQIPE**

**VITI MËSIMOR
2009-2010**

NËNTOR, 2009

Lënda e gjuhës shqipe, në përmbyllje të ciklit nëntëvjeçar, është provim i detyruar për të gjithë nxënësit që e përfundojnë atë.

Provimi i gjuhës shqipe do të zhvillohet mbi bazën e një programi orientues, i cili ndihmon të gjithë nxënësit dhe mësuesit në fazën parapërgatitore.

Programi synon të japë përmbledhjen e njohurive kryesore që zënë peshën më të madhe gjatë viteve të shkollimit.

Programi orientues është hartuar duke u mbështetur te:

- programet e lëndës së gjuhës shqipe, klasa II-IX;
- udhëzimet dhe materialet e dhëna nga MASH-i;
- mendimi i grupeve të interesit;
- takimi me stafin drejtues të IKT-së dhe specialistë të AVA-s.

Kërkesa që duhen marrë parasysh për testin e provimit të gjuhës shqipe:

1. Integrimi i gjuhës shqipe dhe leximit;
2. Pësha specifike e linjave;
3. Konceptet, njohuritë dhe shprehjet e linjave;
4. Fragmenti ose fragmentet e përzgjedhura mund të jenë të llojit letrar ose joletrar, por nuk duhet të jenë pjesë përbërëse e altermteksteve.
5. Fragmenti ose fragmentet e përzgjedhura duhet të jenë *detyrimisht* në përshtatje me moshën e nxënësve.

Tabela e peshës specifike sipas linjave

Nr.	Linja	Përqindja
1.	Të lexuarit	45
2.	Të shkruarit	15%
3.	Njohuri të sistemit gjuhësor	40
	a. Morfologji	13%
	b. Sintaksë	12%
	c. Leksikologji&Fjalëformim	5%
	d. Kulturë gjuhe	2%
	e. Drejtshkrim, pikësim	8%
	Totali	100%

Tabela 1

1. Të lexuarit

Konceptet, njohuritë dhe shprehitë

Nxënës/i,-ja duhet:

- të përcaktojë llojin e tekstit (letrar, joletrar) dhe gjininë e tij;
- të zbulojë personazhe, mjedise, gjendje, veprime, marrëdhënie dhe qëndrime në një tekst të dhënë;
- të dallojë jo më pak se tri elemente karakterizuese për personazhe, mjedise, gjendje, veprime, marrëdhënie etj. në një tekst të dhënë;
- të shpjegojë sjellje, qëndrime dhe marrëdhënie mes personazheve;
- të gjejë figura letrare, si: epiteti, krahasimi, hiperbola, metafora, personifikimi në një tekst të dhënë;
- të zbërthejë figurat letrare duke treguar funksionin shprehës të tyre;
- të dallojë fjalët me ngjyrim emocional, duke zbuluar përdorimin artistik të tyre;
- të përmbledhë idetë e një teksti të dhënë;
- të vlerësojë idetë e një teksti;
- të përcaktojë temën dhe idenë e pjesës së lexuar;
- të gjejë fjalët kyç që ndihmojnë në trajtimin e temës dhe në përshkrimin e personazheve;
- të përcaktojë informacionin më të rëndësishëm në një tekst;
- t'u përgjigjet pyetjeve: kush? ku? kur? pse? çfarë? si?, duke përdorur ilustrime nga teksti;
- të identifikojë kuptimin e parë dhe të figurshëm të fjalëve;
- të dallojë elemente fantastike në një tekst fantastiko-shkencor;
- të gjejë një titull tjetër të figurshëm, të ndryshëm nga titulli i tekstit të dhënë;
- të dallojë detaje artistike të përshkrimit, p.sh.: të një personazhi, të natyrës etj.;
- të dallojë hyrjen, zhvillimin, pikën kulmore dhe mbylljen në një tekst të dhënë;
- të bëjë pyetjet e duhura përpara, përgjatë dhe pas leximit të tekstit;
- t'u përgjigjet pyetjeve në mënyrë logjike përpara, përgjatë dhe pas leximit të tekstit;
- të gjejë zgjidhje për konfliktin e dhënë në një fragment, duke e argumentuar atë;
- të zbulojë domethënien e një fragmenti a teksti;
- të zbulojë mesazhin në një tekst të dhënë;
- të përdorë ilustrime nga pjesa për një qëllim të caktuar: për të argumentuar, për të dhënë detaje shtesë etj.

Tabela e përqindjeve sipas nënlinjave të të lexuarit

Nr.	Nënlinjat	Përqindjet
1	Të lexuarit për të kuptuar pjesën dhe për të marrë informacion	30%
2	Të lexuarit për dëshirë dhe zhvillimin e ndjenjës	30%

3	Të lexuarit për të mbajtur qëndrim (reflektuar) për idetë e pjesës	30%
4	Gjuha e veprave letrare	10%
	Totali	100%

2. Të shkruarit¹

Konceptet, njohuritë dhe shprehjet për të shkruarit: funksional, për nevoja vetjake, me ndjenjë dhe imagjinatë.

Nxënës/i,-ja duhet:

- të shkruajë për lexues të ndryshëm: mësues, prindër, shokë, të afërm;
- të përdorë parashkrimin duke u mbështetur tek të dhënat që ofrojnë materialet parapërgatitore ose situata për të cilën shkruan;
- të shkruajë për të dhënë informacion për të tjerët nëpërmjet përshkrimit dhe argumentimit;
- të përshkruajë përvoja vetjake dhe veprimtari të kryera në grup;
- të përshkruajë dukuri të natyrës sipas këndvështrimit të tij imagjinar;
- të hartojë me shkrim zgjidhje për situata të ndryshme të karakterit fantastiko-shkencor;
- të shkruajë me qëllim të caktuar rreth gjetjeve të reja në shkencë apo fusha të tjera;
- të përshkruajë heronjtë e tij imagjinarë duke përdorur fjalorin e duhur;
- të shkruajë ese argumentuese;
- të shkruajë ese përshkruese;
- të shkruajë përmbledhje;
- të shkruajë një mbyllje tjetër, të ndryshme nga varianti i dhënë;
- të shkruajë CV, autobiografi, fletë ditari, letër formale dhe joformale;
- të përdorë elementet e përshkrimit;
- të zbatojë kërkesat gjuhësore sipas llojit të shkrimit.

Tabela e llojeve të të shkruarit²

Nr.	Të shkruarit	Përqindja
1	Të shkruarit funksional	30%
2	Të shkruarit për nevoja vetjake	30%
3	Të shkruarit me ndjenjë dhe imagjinatë	40%
	Totali	100%

3. Njohuri të sistemit gjuhësor

¹Nxënësit mund të provohen për të shkruar tekste të llojeve të ndryshme, për të cilat ata janë ushtruar gjatë viteve të shkollimit.

² Përqindjet janë rezultat i përlogaritjeve nga klasa 2-9 brenda linjës së të shkruarit, prandaj ato duhen marrë brenda kontekstit të 15% që zë linja e të shkruarit në tabelën 1.

Konceptet, njohuritë dhe shprehitë

Nxënës/i,-ja duhet:

- të dallojë klasat e fjalëve;
- të përcaktojë gjininë, numrin dhe rasën e emrit;
- të përcaktojë formën, mënyrën, vetën, numrin, kohën e foljeve;
- të dallojë foljet vetore, njëvetore dhe pavetore;
- të përcaktojë llojin e përemrave;
- të përcaktojë veçoritë gramatikore të përemrave të ndryshëm;
- të dallojë trajtat e shkurtra dhe të bashkuara (të tri pozicionet);
- të dallojë trajtat e shkurtra nga nyja e gjinore, nyja e emrave prejfoljorë dhe e mbiemrave të nyjshëm;
- të dallojë pjesëzën **u** të joveprores nga trajta e shkurtër **u**;
- të dallojë përemrin vector të vetës së tretë nga përemri dëftor *ai*;
- të përcaktojë llojin e fjalisë sipas kumtimit, intonacionit;
- të dallojë foljet *kam* dhe *jam* me funksion të mëvetësishëm dhe ndihmës;
- të dallojë format e pashtjelluara;
- të përcaktojë funksionet e formave të pashtjelluara;
- të dallojë lidhëzat;
- të dallojë parafjalët;
- të dallojë fjalët sipas formimit: të thjeshta dhe jo të thjeshta (të prejardhura, të përbëra, të përngjitura);
- të ndërtojë familjen e fjalëve të ndryshme me jo me pak se 4 fjalë;
- të analizoje fjalën sipas ndërtimit;
- të krijojë çifte sinonimie dhe antonimie;
- të analizoje fjalën sipas fjalëformimit;
- të tregojë llojin e fjalisë sipas ndërtimit (përbërjes);
- të tregojë llojin e fjalisë sipas modalitetit: mohore, pohore;
- të tregojë llojin e fjalisë sipas qëllimit të thënies: dëftore, pyetëse, nxitëse, dëshirore, thirrmore;
- të tregojë llojin e fjalisë sipas gjymtyrës kryesore: dykryegjymtyrëshe dhe njëkryegjymtyrëshe;
- të emërtojë llojin e fjalisë njëkryegjymtyrëshe sipas llojit të gjymtyrës;
- të ndërtojë fjali të thjeshta sipas një skeme të dhënë;
- të zgjerojë fjali të thjeshta;
- të zvogëlojë fjali të thjeshta;
- të shndërrojë fjalinë e thjeshtë në të përbërë;
- të emërtojë funksionet gramatikore të gjymtyrëve në një fjali të dhënë;
- të tregojë me çfarë shprehen funksionet gramatikore në fjali;
- të dallojë ndajshtimin nga përcaktori;
- të dallojë ligjëratën e drejtë nga e zhdrejta;
- të përdorë saktë shenjat e pikësimit brenda dhe në fund të fjalisë;
- të shkruajë drejt bashkëtingëlloret e zëshme në trup dhe në fund të fjalës;
- të përdorë saktë bashkëtingëlloret nistore: *sh, zh, ç, s, z*;
- të përdorë drejt zanoret: *i/y, u/y*;

- të përdorë drejt nyjen e përparme te mbiemrat;
- të shkruajë drejt fjalët kur takohen dy shkronjave të njëjta;
- të shkruajë saktë fjalët që përmbajnë grupet e zanoreve: ye, ua, ie;
- të përdorë drejt bashkëtingëlloren: h, j, rr;
- të shkruajë drejt fjalët që mbarojnë me: -ër, -ërr, ël në shumës;
- të përdorë njohuritë sintaksore për të shkruar saktë fjalinë.

a. Tabela³ me përqindje për konceptet kryesore në **morfologji**

Nr.	Koncepte	Përqindja
1	Emri	19%
2	Folja	34%
3	Ndajfolja ⁴	1%
4	Përemri	17%
5	Mbiemri	14%
6	Lidhëzat	4%
7	Parafjala	3%
8	Numërori	3%
9	Klasa e fjalëve	5
	Totali	100%

b. Tabela⁵ me përqindje për konceptet kryesore në **sintaksë**

Nr.	Koncepte	Përqindja
1	Kryefjala	8%
2	Kallëzuesi	5%
3	Kundrinori	10%
4	Përcaktori (ndajshtimi)	10%
5	Rrethanori	14%

³ Përqindjet janë rezultat i përlogaritjeve nga klasa 2-9 brenda fushës së morfologjisë, prandaj ato duhen marrë brenda kontekstit të 13% që zë morfologjia në tabelën 1.

⁴ Ndajfolja është përfshirë në tabelën e koncepteve kryesore, pasi ajo rimerret edhe tek klasa e fjalëve e rrethanori. Kjo do të thotë që nxënësi e trajton këtë koncept në disa këndvështrime dhe përqindja e saj rritet natyrshëm.

⁵ Përqindjet janë rezultat i përlogaritjeve nga klasa 2-9 brenda fushës së sintaksës, prandaj ato duhen marrë brenda kontekstit të 12% që zë sintaksa në tabelën 1.

6	Grupi emëror	5%
7	Grupi foljor	5%
8	Zhvendosja e fjalëve	2%
9	Fjalja e thjeshtë, teksti, fjalja	14%
10	Fjalja e thjeshtë sipas kumtimit dhe gjymtyrëve	12%
11	Shndërrimet sipas gjymtyrëve	3%
12	Fjalja e përbërë me bashkërenditje dhe nënrenditje	9%
13	Gjymtyrët homogjene	1%
14	Ligjërata e drejtë	2%
	Totali	100%

Tabela⁶ me përqindje për konceptet kryesore në leksikologji dhe fjalëformim

Nr.	Konceptet	Përqindja
1	Fjalëformimi	40%
2	Sinonimet dhe antonimet	30%
3	Familja e fjalëve	30%
	Totali	100%

⁶ Përqindjet janë rezultat i përlllogaritjeve nga klasa 2-9 brenda fushës së leksikologjisë dhe fjalëformimit, prandaj ato duhen marrë brenda kontekstit të 5% që zë leksikologjia dhe fjalëformimi në tabelën 1.